



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 2176/1 prot.

Tiranë më 6.1.2022

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për informacionin e klasifikuar”

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr.6239/1 Prot., datë 29.12.2021, me anë së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për informacionin e klasifikuar” së bashku me relacionin shoqërues, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Vlen të theksojmë se nga përmbajtja e projektligjit në tërësi, vërejmë se implementohen parimet dhe rregullat e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndërkohë, do t’u sugjeronim që në pikën 7, të nenit 6, të projektligjit, pas togfjalëshit “...përmbajtjen e informacionit të klasifikuar” të shtohet togfjalëshi “...dhe të ruaj konfidencialitetin e të dhënave...”.

Gjithashtu, me qëllim unifikimin e terminologjisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që në nenin 33 të projektligjit, në titull dhe në përmbajtjen e këtij neni, termi “*trajtimi*” të zëvendësohet me termin “*përpunimi*”.

Me sugjerimet e mësipërme, projektligji vlerësohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

